



Gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në forumin “GRUAJA, PAQJA DHE SIGURIA”, zhvilluar në Kosovë

Me iniciativë të presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, zëvendëskryeministres dhe ministres së Punëve të Jashtme, Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, në Prishtinë u organizua Edicioni i Parë i Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (GPS). Me ftesë të presidentit të Kosovës në këtë forum mori pjesë edhe gjeneralmajor Shehu e autorizuar nga Ministri i Mbrojtjes.

Në edicionin e parë të GPS-së, morën pjesë mbi 125 folës dhe mbi 500 pjesëmarrës nga 33 shtete, që shtrihen në 6 kontinente nga vende të ndryshme të botës, midis tyre lider botërorë, ekspertë, akademikë, përfaqësues të shoqërisë civile, të rinj dhe përfaqësues nga grupe të tjera të interesit. Forumi ndërkombëtar pati si qëllim reflektimin e punës mbi sukseset dhe sfidat e kësaj axhende, 22 vite pas miratimit të

Rezolutës 1325 të OKB-së “Gruaja, Paqja dhe Siguria” si dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi nevojën për të njohur e promovuar aftësitë e grave dhe vajzave për të kontribuar në mënyrë aktive e përmbytësore në procese të paqes dhe sigurisë. Ky edicion i parë i Forumit iu dedikua trashëgimisë së ish-sekretares së SHBA-ve, Madeleine Albright. Organizimi i këtij Forumi ndërkombëtar ishte një ndër... » faqe 2



SHSHP të FARSH, vizitë zyrtare në Kosovë

Gjeneral brigade Kingji: Është koha për qasje të përbashkët dhe koordinim të qëndrimeve mbi rreziqet, sfidat në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë në rajon



Gjeneral brigade Arben Kingji ndjek nga afër stërvitjen “Flotex-22”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, i shoqëruar nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare, kapiten i rangut I Ferdinand Kreshpani, zhvilloi një vizitë inspektuese të stërvitjes “Flotex-22”, faza e ekzekutimit të së cilës u zhvillua në Gjirin e Vlorës. Stërvitja “Flotex” është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, pasi shërben për vlerësimin dhe certifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Flotiljes Detare në realizimin e misionit dhe detyrave të saj themelore.... » faqe 2



Atashetë ushtarakë të vendeve të NATO-s vizitojnë Komandën e Forcës Tokësore

Një grup atashesh të vendeve anëtare të NATO-s, vizituan sot paradite Komandën e Forcës Tokësore. Ata u pritën nga zëvendëskomandanti i FT-së gjeneral brigade Ferdinand Dima dhe shtabi i kësaj strukture. Më tej, vizita e atashëve vijoi me prezantimin e përgatitjes nga Dega e Planifikimit (G-5/8). Nëpërmjet një brifingu të mbajtur nga shefi i Degës së G-5/8, kolonel Agim Shahu, atashetë ushtarakë u njohën me misionin, detyrat si dhe angazhimet e efektivëve të Forcës Tokësore në... » faqe 2



Shkolla Shqipe e Vashave, e krijuar prej pluhurit të shkretëtirës në shtyllën e fortë, për të ndriçuar kombin

131 vite më parë, më 23 tetor 1891, u hap “Shkolla e Vashave” në Korçë nga familja e njohur Qiriaz. Hapja e kësaj shkolle shënonte një hap me rëndësi pasi do të edukonte vajzat, të cilat për kohën nuk e gëzonin privilegjin për t’u arsimuar, sidomos në gjuhën amtare. Shkolla e Vashave ka qenë një shkollë me standarde europiane për kohën, me një bibliotekë mjaft të pasur dhe laborator kërkimor për shkencat e natyrës. “Historia e shkollës së parë shqiptare për vasha, - shkruan në kujtimet e veta Sevasti Qiriaz, - është si një romancë plot... » faqe 11



Gjeneral brigade Arben Kingji ndjek nga afër stërvitjen “Flotex-22”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, i shoqëruar nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare, kapiten i rangut I Ferdinand Kreshpani, zhvilloi një vizitë inspektuese të stërvitjes “Flotex-22”, faza e ekzekutimit të së cilës u zhvillua në Gjirin e Vlorës.

Stërvitja “Flotex” është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, pasi shërben për vlerësimin dhe certifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Flotiljes Detare në realizimin e misionit dhe detyrave të saj themelore. E veçantë në stërvitjen e këtij viti ishte realizimi i qitjeve detare me armatimin e anijeve, bazuar në skenarë të supozuar.

Në prezantimin e stërvitjes, komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i rangut I Engjell Sinanaj, njohu shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së me qëllimin, objektivat dhe skenarin e stërvitjes.

Stërvitja “Flotex” është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, pasi shërben për vlerësimin dhe certifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Flotiljes Detare në realizimin e misionit dhe detyrave të saj themelore. E veçantë në stërvitjen e këtij viti ishte realizimi i qitjeve detare me armatimin e anijeve, bazuar në skenarë të supozuar.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, i shoqëruar edhe nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare, kapiten i rangut I Ferdinand Kreshpani, ndoqi nga afër zhvillimin e stërvitjes së Forcës Detare, “Flotex-22”, e cila u zhvillua në Gjirin e Vlorës.



vihtes së Forcës Detare, “Flotex-22”, e cila u zhvillua në Gjirin e Vlorës.

Qëllimi i stërvitjes ishte rritja e ndërveprueshmërisë midis mjeteve detare dhe Grupit të Bordingut të Flotiljes Detare, si dhe testimi i procedurave të zbatimit të ligjshmërisë detare për operacionet e Ndalimit Detar dhe Kërkim-Shpëtimit (SAR).

Në fjalën e tij, gjeneral brigade Kingji vlerësoi profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar nga efektivat pjesëmarrëse në këtë stërvitje.



Stërvitja “Flotex” është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, pasi shërben për vlerësimin dhe certifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Flotiljes Detare në realizimin e misionit dhe detyrave të saj themelore. E veçantë në stërvitjen e këtij viti ishte realizimi i qitjeve detare me armatimin e anijeve, bazuar në skenarë të supozuar.

Atashetë ushtarakë të vendeve të NATO-s, vizitojnë Komandën e Forcës Tokësore

Një grup atashesh të vendeve anëtare të NATO-s, vizituan sot paradite Komandën e Forcës Tokësore. Ata u pritën nga zëvendëskomandanti i FT-së gjeneral brigade Ferdinand Dimo dhe shtabi i kësaj strukture.

Më tej, vizita e atashëve vijoi me prezantimin e përgatitur nga Dega e Planifikimit (G-5/8). Nëpërmjet një brifingu të mbajtur nga shefi i Degës së G-5/8, kolonel Agim Shahu, atashetë ushtarakë u njohën me misionin, detyrat si dhe angazhimet e efektivëve të Forcës Tokësore në misionet ndërkombëtare.

Një pikë tjetër mjaft e rëndësishme, ku u ndal kolonel Shahu gjatë prezantimit të tij, ishte edhe kontributi i Forcës Tokësore në kuadër të Emergjencave Civile në ndihmë të popullsisë. Vizita vijoi më pas në formën e një diskutimi të lirë, me pyetje-përgjigje nga të pranishmit.



SHSHP të FARSH, vizitë zyrtare në Kosovë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi vizitën e parë zyrtare bilaterale në Kosovë.

Në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, gjeneral brigade Arben Kingji, u prit me nderimet më të larta nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari.

Në takimin e zhvilluar mes dy delegacioneve, gjeneral brigade Kingji vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin e deritanishëm midis Forcave tona të Armatosura dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës, njëkohësisht u shpreh i vendosur për ta çuar përpara këtë bashkëpunim duke identifikuar mundësi të reja praktike të përbashkëta. Kjo do të shërbejë në ngritjen e kapaciteteve ekzistuese dhe të reja ushtarake. “Ka ardhur koha që të kemi një përqasje të përbashkët dhe koordinim të qëndrimeve mbi rreziqet, sfidat në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë në rajon. Në nivelin ushtarak, mbështesim procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës sipas standardeve të NATO-s”, - u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Kingji.

Nga ana e tij, gjenerallejtënant Jashari shprehu mirënjohje për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, nën leadershipin e gjeneral Kingjit, për kontributin e veçantë në zhvillimin dhe avancimin e aftësive dhe kapaciteteve operationale të FSK-së, veçanërisht në fushën e arsimimit dhe stërvitjes.

Më pas, gjeneral brigade Kingji u prit në një takim të veçantë edhe nga Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj. Me këtë rast, Mehaj i shprehu gjeneral brigade Kingjit falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për Republikën e Shqipërisë për mbështetjen vëllazërore të ofruar në të gjitha periudhat e ndër-

Gjeneral brigade Kingji: Është koha për qasje të përbashkët dhe koordinim të qëndrimeve mbi rreziqet, sfidat në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë në rajon



timit, zhvillimit, si dhe në të gjitha arrijtjet e deritashme të vendit, sikur edhe të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Gjeneral Kingji në fjalën e tij u shpreh se: “Nga ana ime, në të gjitha takimet dhe konferencat ku kam marrë

pjesë, kam theksuar rëndësinë e përsheptimit të procesit të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në të gjitha organizmat dhe nismat rajonale dhe ndërkombëtare, për vetë të ardhmen e Kosovës dhe rajonit.

Axhenda e vizitës zyrtare të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji ka vijuar me një vizitë edhe Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, ku është njohur me arrijtjet e deritashme, sfidat

dhe aktivitetet e planifikuara të FSK-së për të ardhmen.

Gjatë vizitës dyditore, shefi i Shtabit të Përgjithshëm është pritur nga komandanti i KFOR-it gjeneralmajor Angelo Ristuccia.

Gjeneral brigade Kingji nga ana e tij, vlerësoi rolin e pazëvendësueshëm të NATO-s dhe KFOR-it për ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në Kosovë dhe në gjithë rajonin. Shqipëria do të jetë gjithmonë një mbështetës dhe kontribues i misionit të KFOR, me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë së sigurisë në Kosovë dhe rajon.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, zhvilloi vizitë në komandën rajonale në Pejë, ku është takuar me komandantin e kazermës kolonel Ivano Marotta, si dhe efektivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, pjesë e misionit paqeruajtës, KFOR.



Trupat komando të ROS përfundojnë me sukses stërvitjen “KFOR-31”



Trupat komando të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS), përfunduan me sukses stërvitjen “KFOR-31”. Për një periudhë rreth njëmuajore, një kompani e këtyre trupave mori pjesë në stërvitjen “KFOR-31”, të zhvilluar në një nga bazat më të mëdha amerikane të trajnimit në Europë, siç është “Joint Multinational Readiness Center”, Hohenfels, Gjermani.

Ndër temat kryesore stërvitore, që u aplikuan gjatë “KFOR-31” ishin kontroll turme, patrullim me mjete dhe në këmbë, sigurimi i lirisë të lëvizjes, reagimi ndaj minave të improvizuara etj. Efektivët e Regjimentit të Operacioneve Speciale, të përfaqësuar nga kompania I komando treguan disiplinë të lartë dhe profesionalizëm, në çdo detyrë të



ngarkuar gjatë këtij trajnimit.

Në përfundim të “KFOR-31”, në analizën e zhvilluar nga pala amerikane që drejtonte stërvitjen, u vlerësua me nota pozitive, angazhimi dhe profesionalizmi i treguar nga personeli shqiptar i trupave komando.

“KFOR-31”, është një stërvitje ndërkombëtare e përvitshme, e cila zhvillohet me qëllim përgatitjen e trupave ndërkombëtare, për dislokim në Kosovë nën komandën e KFOR-it.

Forca Tokësore zhvilloi takimin dypalësh “ALB-ITAL Army Staff Talks”

Në kuadër të bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes, mes Forcave të Armatosura italiane dhe atyre shqiptare, sot në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore, u zhvillua aktiviteti “ALB-ITAL Army Staff Talks”.

Qëllimi i këtij aktiviteti, ishte realizimi i bisedimeve dypalëshe me fokus kryesor realizmin e planit të bashkëpunimit për vitin 2022, si dhe diskutimin e aktiviteteve të planit të bashkëpunimit për vitin 2023.

Ekipi i ushtarakëve italianë u prit fillimisht nga zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo. Në bisedën me ushtarakët italianë, gjeneral Dimo e vuri theksin tek bashkëpunimi i shkëlqyer që ekziston midis dy ushtrive tona.

Ai theksoi gjithashtu se, kontributi i përbashkët që japin në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut dy vendet tona mike dhe aleate, është një kontribut i cili natyrshëm rrjedh edhe nga bashkëpunimi ynë i ndersjellë.

Në këtë kuadër, gjeneral



Dimo falënderoi palën italiane për mbështetjen që i kanë dhënë efektivëve të Forcës Tokësore, sidomos në trajnimin e personelit. Ai shprehu besimin se ky bashkëpunim, do të vijojë të thellohet edhe në të ardhmen.

Takimi dypalësh, vijoi më tej në nivel ekspertësh, ku u diskutuan arritjet gjatë vitit 2022 si dhe mundësitë e reja për bashkëpunim afatgjatë gjatë vitit 2023.



Ekupazhet e helikopterëve zhvillojnë stërvitje për rritjen e aftësive profesionale në fluturimet natën

Në aerodromin e Bazës Ajrore Farkë është zhvilluar stërvitje ajrore me fluturime natën, kjo stërvitje ka qenë pjesë e programeve stërvitore për rritjen e aftësive profesionale të ekupazheve ajrore. Fluturimi në kushtet të shikueshmërisë së reduktuar është një nga përbërësit themelor të stërvitjes së vazhdueshme ajrore për pilotët. Fluturimet stërvitore, shërbejnë më së miri për rritjen e aftësive operacionale për përdorimin e mjeteve ajrore në operacione natën. Gjithashtu, fluturimet vizuale natën aftësojnë ekupazheve ajrore në përdorimin e mjeteve të shikimit natën me NVG (Night Vision Goggles - Devices).

Operacionaliteti dhe gatishmëria është në fokusin e veprimtarisë së Forcës Ajrore, mjetet ajrore ofrojnë kapacitete për përdorim në një spektër të gjerë të përdorimit operacional, duke përmbyshur kështu realizimin e detyrave në konceptin e mbështetjes së trupave në terren dhe realizimin e misionëve të emergjencave civile. Trajnimi dhe stërvitja për fluturimet natën u paraprijnë planeve të modernizimit të Forcës Ajrore me helikopterë të rinj të tipit UH60 Black Hawk të cilët ofrojnë kapacitete operacionale për fluturime me NVG në kushte të shikueshmërisë së reduktuar.



Maratona e Tiranës "Vrapo për Paqen" sjell trofeun në FA

Në maratonën e Tiranës "Vrapo për Paqen" morën pjesë 230 vrapues nga radhët e Forcave të Armatosura duke arritur rezultate nderi.

Përgëzime për Kampionen europiane të atletikës dhe krenaria e FARSH-së, tetare Luiza Gega në zënien e vendit të parë në gjysmë maratonën e Tiranës dhe për thyerjen e rekordit kombëtar, duke përshkruar 21 km për 70 minuta dhe 18 sekonda.

Përmes sportit nxisim dhe kultivojmë vlerat më të mira njerëzore dhe shoqërore.





Gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në forumin “GRUAJA, PAQJA DHE SIGURIA”, zhvilluar në Kosovë

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Gratë, jo vetëm në nivel kombëtar, por në nivel global duhet të ngrenë fuqishëm zërin që femrat ushtarake dhe jo vetëm, të jenë të vlerësuara dhe të meritojnë vendin që u takon

Me iniciativë të presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, zëvendëskryeminstres dhe ministres së Punëve të Jashtme, Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, në Prishtinë u organizua Edicioni i Parë i Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (GPS).

Me ftesë të presidentit të Kosovës në këtë forum mori pjesë edhe gjeneralmajor Shehu e autorizuar nga Ministri i Mbrojtjes.

Në edicionin e parë të GPS-së, morën pjesë mbi 125 folës dhe mbi 500 pjesëmarrës nga 33 shtete, që shtrihen në 6 kontinente nga vende të ndryshme të botës, midis tyre lider botërorë, ekspertë, akademikë, përfaqësues të shoqërisë civile, të rinj dhe përfaqësues nga grupe të tjera të interesit.

Forumi ndërkombëtar pati si qëllim reflektimin e punës mbi sukseset dhe sfidat e kësaj axhende, 22 vite pas miratimit të Rezolutës 1325 të OKB-së “Gruaja, Paqja dhe Siguria” si dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi nevojën për të njohur e promovuar aftësitë e grave dhe vajzave për të kontribuar në mënyrë aktive e përmbytësore në procese të paqes dhe sigurisë.

Ky edicion i parë i Forumit iu dedikua trashëgimisë së ish-sekretares së SHBA-ve, Madeleine Albright. Organizimi i këtij Forumi ndërkombëtar ishte një ndër zotimet në kuadër të Samitit për Demokraci. Forumi synoi të përconte qartë mesazhin, se paqja dhe siguria e grave janë shtyllat qendrore të vizionit të Kosovës për paqe të qëndrueshme në nivel vendor, rajonal dhe global.

Forumi GPS u zhvillua në një kohë kur paqja, liria dhe siguria po sulmohen në zemër të Europës, teksa gratë e vajzat sërish janë në qendër të dhunës, torturës dhe trajtimit çnjerëzor.

Forumi u fokusua në “Ndërtimin e aleancave për paqe të qëndrueshme” dhe do të shërbejë si platformë për shkëmbimin e praktikave më të mira dhe mësimet të nxjerra nga përvojat e vendeve pjesëmarrëse, zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe të balancuara gjinore, si dhe hartimin e kornizave të reja të veprimit në vazhden e ndryshimeve të vazhdueshme të arkitekturës së sigurisë dhe paqes në Europë e më gjerë.

Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, e cila hapi edicionin e parë të Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, ndërmjet të tjerash u shpreh: “Historia e Kosovës është histori e secilës grua, e cila ka larguar një gur nga rruga drejt baraz-



rëndësisë së grave, Osmani ka përmendur edhe luftën aktuale të Ukrainës me shtetin rus, gjersa ka theksuar se të pranishëm në forum ka edhe ukrainas.

Në këtë forum, Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, u ka ndarë çmimin presidencial për trimërinë dhe kontributin grave të Ukrainës. Forumin e kanë përshëndetur mjaft personalitete të larta botërore, të cilët ishin prezentë, por edhe nëpërmjet videove online. Kështu Sekretari i Shtetit i ShBA-së, Antony Blinken, në Forumin për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, nëpërmjet një lidhjeje online me video ka thënë se, lufta në Kosovë është fituar sepse aleanca ishte e bashkuar dhe e fortë. “Lufta në Kosovë ishte një përballje mes vrasjeve barbare dhe forcës së nevojshme, ndërmjet mos tolerancës së dhunshme dhe respektimit të drejtave të njeriut, mes tiranisë dhe demokracisë. Ne fituam sepse aleanca jonë ishte e bashkuar dhe e fortë. Më e rëndësishmja, ne ia dolëm sepse kauza jonë ishte e drejtë dhe për shkak të popullit të Kosovës”, - ka cituar fjalët e zonjës Albright, Sekretari Blikën. Ai ka falënderuar Presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, për organizimin e këtij forumi.

Gjithashtu edhe Presidentja e Parlamentit Europian, Roberta Metsola përmes një video-mesazhi i është adresuar Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Ajo ka folur për gratë në Ukrainë, duke thënë se nga të mësojmë kurajën dhe frymëzimin. Metsola gjithashtu u shpreh se Bashkimi Europian ka qenë gjithmonë i përkushtuar që të ndihmojnë gratë.

Bashkimi Europian ka qenë gjithmonë i përkushtuar që të ndihmojnë gratë përmes agjendës për “Gratë, Sigurinë dhe Paqen”, duke punuar me OKB-në, me NATO-n për të fuqizuar gratë dhe për t’u dhënë rol në arritjen e paqes. Bashkimi Europian qëndron në këtë agjendë dhe kemi kërkuar përfshirjen e më shumë grave dhe të gjitha shteteve anëtare të BE-së, derisa stafi i BE-së duhet të kenë trajnim mandator për barazinë gjinore”, - tha ajo.

Zëvendësmintreja e Parë e Jashtme e Ukrainës, Emine Japarov, në Forumin për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, ka folur për sfidat nëpër të cilat janë duke kaluar gratë ukrainase në luftën e nisur nga Rusia në këtë vend. Ajo në një moment e krahasoi presidentin rus, Vladimir Putin, me ish-presidentin serb, Slobodan Millosheviq, i cili kreu gjenocid në Kosovë. Ajo tha se Putini është Millosheviqi i ri, ku të dy i kanë duart e njoollura me gjak. “30 mijë ushtarë kanë luftuar krah me burrat në Ukrainë, nuk lodhen. Ato po sakrifikojnë jetën e tyre për një Ukrainë të lirë e të pavarur. Njëkohësisht Rusia i mban rob me qindra gra, edhe ato shtatzëna. Gratë keqtrajtohen e burgosen. Jetët e vajzave dhe grave në Ukrainë janë në rrezik, sidomos i atyre nën okupim”, - ka thënë Japarov. “Sot Putini është Millosheviqi i ri, të dy i kanë duart e njoollura me gjak”, - ka shtuar ajo.

“Në emër të të gjitha grave ukrainase dua të ju falënderoj për mirënjohjen, për trimërinë dhe rezistencën e grave të Ukrainës. Jam e sigurt që medalja presidenciale që i ndatë të gjitha grave të Ukrainës, që ju i përfaqësoni sot, do t’i inkurajojë nënat, gratë, mjeket, gazetaret dhe të gjitha gratë e Ukrainës për arritje të mëtejshme”, - ka shtuar ajo.

Kryeministri i Kosovës z. Albin Kurti, në Forumin Ndërkombëtar “Gratë, Paqja dhe Siguria”, ka thënë se populli i Kosovës u beson grave po aq sa burrave. Ai tha se kur bëhet fjalë për çështjet e

organizimin e këtij takimi të rëndësishëm, që ndodh në një kohë kur paqja, liria dhe siguria janë nën sulm në zemër të Europës.

Në konfliktet e sotme, më shumë se 70% e viktimave janë civilë, shumica prej tyre gra dhe fëmijë. Lufta, konflikti, terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm kanë pasojë të ndryshme dhe shkatërruese për gratë dhe vajzat. Përballë kësaj, gratë në të gjithë botën janë duke udhëhequr lëvizjet për paqe (Iran, Afganistan) dhe rindërtimin e komuniteteve. Ekzistojnë prova të forta që sugjerojnë se pjesëmarrja e grave në proceset e paqes, kontribuon në paqe më të gjatë dhe më elastike pas konfliktit. Për fat të keq, pavarësisht kësaj, gratë mbeten kryesisht të padukshme dhe të përjashtuara nga proceset dhe negociatat e paqes. Shpresoj që në të ardhmen të ketë një rritje të përfaqësimit të grave në proceset e paqes dhe sigurisë, si luftëtare apo misionare”.

Në vijim ajo dha përvojën e Forcave të Armatosura shqiptare në zbatimin e Barazisë Gjinore,

sigurisë, qytetarët e institucionet kanë caktuar si komandante Supreme, presidenten e vendit, Vjosa Osmani. Sipas Kurtit, gratë i përgjigjen thirrjeve të çdoditshme për paqe dhe siguri, sikur të jetë përpjekja e tyre jetësore, pasi sipas tij, gratë janë më të interesuara për politikën e paqes dhe sigurisë sepse edhe kërcënohen më së shumti nga mungesa e këtyre elementeve. “Nuk ka pasur ndonjë fazë që gratë s’janë angazhuar me thirrje e përpjekje për liri e paqe. Angazhimi i grave dhe vajzave në Kosovë s’ka mundur asnjëherë në shtet-ndërtim por nuk mungon as në funksionimin e shtetit tonë të përditshëm”.

Në forum e kanë marrë fjalën edhe shumë personalitete të tjera të politikës, shkencës e shoqërisë civile.

Më tej forumi ka vijuar me panele.

Kështu zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu ka marrë pjesë në panelin “Gratë në Sektorin e Sigurisë: Sfidimi i stereotipeve gjinore në sektorin e sigurisë”, ku paneliste ishin: Mgr. Bc. Šárka Havránková - nënkryetare e INTERPOL-it, Komiteti Ekzekutiv i INTERPOL-it; LTC Laura L. Lyons - Këshilltare për Politikën e Mbrojtjes, Drejtorja e Operacioneve të Mbrojtjes; Komisionere gjeneral Catherine Bourdes - Ministria e Forcave të Armatosura të Republikës Franceze; Lt. Col. (res.) Avital Leibovich - drejtore e Komitetit Hebre Amerikan në Jerusalem; gjeneral Pamela McGaha - komandante e Shtabit të NATO-s në Sarajevë; gjeneral Irfete Spahiu - inspektore e Forcës së Sigurisë së Kosovës; kolonel Taibe Canolli - drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës; Arta Bilalli Zendeli - shefe e Delegacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, etj.

Gjeneralmajor Shehu, mbasi ka falënderuar presidenten e Kosovës për organizimin e shkëlqyer të këtij forumi dhe për ftesën adresuar Ministrin të Mbrojtjes z. Niko Peleshi, ndër të tjera u shpreh: “Jam thellësisht e nderuar dhe e privilegjuar që jam ndër mikpritësit e këtij edicioni të parë të Forumit të Grave, Paqes dhe Sigurisë. Në emër të Ministrin të Mbrojtjes të Shqipërisë, dëshiroj të përgëzoj për



ku rreth 14.76% e personelit ushtarak janë femra. Më pas ajo u ndal në Planin Kombëtar të Barazisë Gjinore dhe në Planin e Veprimit të Ministrisë së Mbrojtjes, hartuar në mbështetje të rezolutës 1325 të OKB-së “Gruaja, Paqja dhe Siguria”. Roli i femrës ushtarake është rritur ndjeshëm si në arsimim, trajnim, në promovim në detyra e gradë. Femrat ushtarake sot i gjen në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në përfaqësitë tona në NATO, atashe ushtarake, në kryerjen e detyrave operacionale e mbështetëse brenda vendit, të barabarta me kolegët e tyre burra. Në vijim ajo i njohu pjesëmarrësit në panel edhe me hartimin e dokumentit mjaft të rëndësishëm që lidhet me mbrojtjen e femrave ushtarake ndaj dhunës dhe ngacmimeve në pozicionin e punës, dokument i cili është përgatitur dy vite më parë, me asistencën e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri.

Në fund gjeneralmajor Shehu theksoi se të gjitha si gra jo vetëm në nivel kombëtar, por në nivel rajonal dhe global duhet të ngremë fuqishëm zërin që femrat ushtarake të jenë të vlerësuara dhe të meritojnë vendin që u takon.

Gjatë panelit, pjesëmarrësit ndanë me publikun histori suksesi dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së gruas në sektorin e sigurisë. Panelistet inkurajuan pjesëmarrjet të shtuar të grave në sektorin e sigurisë dhe dhanë rekomandime për të zhdukur stereotipet gjinore në këtë sektor të rëndësishëm. Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, organizuar në Kosovë, i mbylli punimet duke dhënë mesazhe të fuqishme për zbatimin e rezolutës “Gruaja, Paqja dhe Siguria”.



isë. Më vjen mirë që kemi mbledhur gra e burra nga çdo kënd i botës. Përpjekja është të sigurohemi që sfidat me të cilat përballemi të tejkalohen”. 22 vite më parë, gratë vizionare dhe të guximshme bashkuan zërat e tyre për të krijuar rezolutën 1325, një akt historik që është gurthemel i asaj që njihet si agjenda për gratë për paqen dhe sigurinë. Ajo ka përmendur edhe diskriminimin e grave në vendet e botës, siç është Irani dhe jo vetëm.

Në këtë forum planifikohej të merrte pjesë edhe tashmë e ndjera, ish-Sekretarja Amerikane e Shtetit, Madeline Albright. Presidente Osmani u shpreh se: “Kishim menduar që zonja Albright do të ishte folësjë kryesore në këtë forum, kur e patëm planifikuar këtë forum, por fatkeqësisht ajo ndërroi jetë. Ajo do të mbetet figurë historike për Kosovën, për kontributin që ka dhënë për sigurinë, paqen dhe lirinë. Ajo ishte frymëzim për ne, zëri ynë kur nuk kishim zë.” Krahas

Histori mbi tunelizimin e zhvillimin e armës së tankeve

Fillimet e armës së tankeve

Arma e tankeve u krijua më 1 prill 1946. Formacioni i parë luftarak, bërthama e saj fillestare u bë kompania e parë e tankeve në Tiranë me 10 tanke, tri toga tankesh me nga 3 tanke secila dhe një tank i komandantit të kompanisë, në ditën e themelimit të armës së tankeve, më 1 prill 1946. Ishte ditë historike për një formacion luftarak që shënonte vetëm rritje sasiore e cilësore nga viti në vit, nga dekada në dekadë, deri sa arriti suksesin në vitin 1960, me formimin e Brigadës së Parë Tankiste në Zall Herr të Tiranës. Në vite, deri në vitin 1975, me formimin e 12 brigadave tankiste në Shkodër, Laç, Sauk të Tiranës, Vorë, Kavajë, Kolonjë e Lushnjës, Fier, Poshnje të Beratit, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë dhe 6 batalione tankiste autonome të vendosur në drejtimet më të rëndësishme të vendit, për përdorimin me efikasitet të menjëhershëm në rast agresioni të mundshëm ndaj vendit tonë. Nga viti 1946 deri në vitin 1960 ushtria shqiptare u furnizua me tanke T-34 dhe u formua në reparte tankiste (batalione tankesh-bt) në Shkodër, Zall Herr të Tiranës, Elbasan, Berat, Gjirokastrë, regjiment tankesh në Korçë.

Pas viteve 1960 ushtria shqiptare u pajis me tanke T-54 (T-59), teknikë e re më e avancuar e kohës. Në vitin 1960 u formua e para brigadë tankesh (BrT), me tanke T-59 në Zall Herr të Tiranës me komandant brigade Abas Fejzo. Më pas, në vijimësi u krijuan brigada të tëra tankesh dhe një sasi e domosdoshme batalionesh tankesh në drejtimet më të rëndësishme të vendit. Vendosja e përqendrimit i formacioneve u bë në drejtimet më të rëndësishme të përdorimit të tankeve, sipas një plani strategjik të mirë përcaktuar në artin ushtarak popullor të kohës. Para drejtuesve tankistë në Ministrinë e Mbrojtjes, në njësitë, repartet, nënrepartet dhe efektivin tankist, dlinin detyra tepër të vështira që kërkonin mobilizim maksimal e sakrificë për realizimin me cilësi dhe shpejtësi të jashtëzakonshme. Drejtuesit dhe efektivit tankist e kanë nisur punën nga e para. Ata ishin vendosur në baraka e ndërtesa që siguronin me shumë vështirësi kushtet minimale për jetesë e stërvitje.

Mbi vendvendosjen dhe ndërtimin e tuneleve

Duhej një plan me detaje për punë në tri drejtime njëherësh, por duhej përcaktuar edhe kush ishte më e rëndësishme për të përqendruar më shumë forca. Drejtimi i parë dhe më kryesori, ndërtimi i tuneleve bazë toge i eksperimentuar, që plotëson kriteret më të favorshme për mbrojtje të teknikës së tankeve e të efektivit nga helmet gjatë veprimeve në tunel dhe dalje të menjëhershme për në detyrë. Realizimi i kësaj detyre kërkonte shpejtësi, saktësi, cilësi e forca më të shumta për plotësimin në kohë të detyrës për futjen sa më shpejt të tankeve në tunel, etj. Drejtimi i dytë, puna për ndërtimin sipas projekteve të miratuara të fjetinave të efektivit, plotësimi me të gjitha pajisjet e nevojshëm sipas standardeve të kohës. Ndërtimi i bllokut të kuzhinës dhe i mensës së efektivit me kapacitetin e nevojshëm dhe plotësimi me të gjitha elementët e nevojshëm. Ndërtimi i ndërtesave për zyra për kuadrot, klasave për mësim, sallat për edukim e argëtim, këndet për aktivitetet sportive e pajisja me të gjitha mjetet e nevojshme. Ndërtimi i objekteve higjieno-sanitare sipas projekteve pajisja e tyre me të gjitha elementet përkatëse. Projektet ishin të gatshme. Kërkohej korrektësi në zbatimin me fanatizëm të tyre. Drejtimi i tretë, ndërtimi i poligoneve dhe fushave të stërvitjes sipas standardeve dhe projekteve të ardhura nga instancat përkatëse. Sigurimi i bazës materiale për të gjitha llojet e stërvitjeve sipas programit vjetor të stërvitjes.

Projekt-programi iu nënshtrua diskutimit në efektivat e njësisve, reparteve e nënreparteve. U bë ndarja e grupeve të punës, ata që do punonin në tunelet e tankeve. Grupi që do punonte në ndërtimin e ndërtesave, të fjetinave, bllokut të mensë-kuzhinës, ndërtesave për zyra etj. Grupi për qendrat e stërvitjeve etj. Për të gjitha objektet u bënë grafikët e punës, ditore, javore, mujore dhe analizat në fund të ditës, javës, muajit etj.

Vendvendosja e objekteve u studiua me hollësi nga specialistë të fushave të tyre. Në vendvendosjen e ndërtimin e tuneleve përveç xhenierëve morën pjesë dhe specialistë të taktikës së tankeve. Vendi i ndërtimit të tunelit caktohej nga specialisti i taktikës së tankeve në bazë të normave të kohës së afrimit e zënies së vijës së hapjes nga toga e tankeve. Mbasi u bënte disa herë lëvizjen e afrimit për në vijat e hapjes me 3 tanke jepte mendimin ku do ndërtohej tuneli i togës së tankeve. Komandant e njësisë dhe reparteve bindeshin se puna përgatitore squaruese, bindëse e organizuese ia kishte arritur qëllimit, fillonte puna.



Myfit Metani, veteran i armës së tankeve shqiptare

Arma e tankeve kishte kuadro të përgatitur

Fillimisht kam qenë në Poshnje të Beratit. Punonim me tri turne. Çdo turn hapte 2 m tunel me përmasat e kërkuara, d.m.th. tuneli i filluar ecte në thellësi 6 m në ditë. Me një ritëm të tillë, kur nuk mungonte baza materiale, toga e tankeve për 2-3 muaj mund të futej në tunel të mbaruar me të gjithë elementet që kërkohehin për të. Edhe në batalionin e tankeve të Marikajt (BrT e Vorës) me atë ritëm punohej. Në të gjitha njësitë, repartet e nënrepartet tankiste ndiqej e njëjta rrugë për të përcaktuar vendin e ndërtimit të tuneleve të tankeve. Kur koha nga tuneli për afrimin te vija e hapjes nuk realizohej për arsye objektive (distanca më e madhe se shpejtësia e mundshme e tankeve), bëhej afrimi i tunelizimit të tyre për ta zënë në kohë vijën e hapjes së tankeve për t'u futur në kohën e duhur në luftim. Fillimisht tunelet u bënë me bazë kompanie, por për eliminim e disa vështirësive të gazrave helmues të shumta gjatë ndezjes së tankeve e kohës më të madhe për daljen nga tunelet të kompanisë u pa më e përshtatshme ndërtimi bazë toge i tuneleve që evitonte mangësitë e përmendura më sipër. Detyrat për realizimin e objektivave të vështira e të shumta kërkonin personel të përgatitur për marrjen e vendimeve të sakta e realizimin në kohë të planit të përcaktuar për ndërtimin e njësisve e reparteve model në shkallë ushtrie me kushte për jetesë e stërvitje. Në krye të përfaqësuesve të tankeve në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, në njësitë e repartet tankiste u vunë kuadro të përgatitur si Abas Fejzo, Adnan Qatipi, Lym Keta, Loni Kristo, Faik Paja, Petref Kalemi, Estref Musabelliu, Demo Liço, Petrit Mançe, Vangjo Monosopi, Aleko Koka, Dino Brati, Dhimitër Mitrushi, Qani Spahiu, Jani Prifti dhe një plejadë e tërë e tankistëve që bënë historinë e ndritur të saj. Ndërtuan njësi e reparte model në të gjithë Shqipërinë për një kohë rekord me të gjitha kushtet për jetesë e stërvitje.

Eliminimi i lagështirës në tunele

Tunelet e tankeve fillimisht kishin lagështirë. Nuk ishte bërë hidro-izolimi gjatë veshjes me beton në tavane e pjesët anësore të tyre. Lagështira dëmton mjetet e vrojimit, qitjes e sistemin elektrik. Në shkurt 1973, në BrT të Korçës erdhi një ekip kontrolli nga Ministria e Mbrojtjes.

Unë, si shefi i shtabit të BrT midis të tjerave ngrita dhe problemin e ekzistencës së lagështirës në tavane, në pjesët anësore e në brendësi të tuneleve të tankeve. Përgjigja ishte: “të bëhet ndërhyrje e menjëhershme për largimin e lagështirës”. Më pas, grupe specialistësh ndërhyjnë në të gjitha njësitë e repartet tankiste. Tunelet e tankeve në sipërfaqet e tavaneve dhe në pjesët anësore u veshën me fibra plastike kundër lagështirës. Ujërat që kulonin nga sipër betonit në pjesët anësore përfundonin në kanalet anësore poshtë dyshemesë dhe përfundonin jashtë e larg tuneleve të tankeve. Në skapamentot e daljes së gazrave u montuan tuba vijues të varur në murin anësor me zgjatim deri jashtë tunelit. Kur shoferët e togës së tankeve futeshin në tanke të vendi i tyre e ndiznin motorin, gazrat helmues fillestarë, nëpërmjet tubacionit në murin anësor, dlinin jashtë tunelit. Evitohej ndikimi i tyre në momentin fillestar. Më tej shoferi i tankut të fillimit i veshur me kundërgaz fillimisht shkëpuste tubin nga skapamentoja e tankut, nxirrte tankun te hyrja, merrte anëtarët e tjerë të ekuipazhit dhe rreshtojë në vendin e vet në kolonë. Edhe dy shoferët e tankeve të tjerë bënin, sipas radhës, të njëjtat veprime e plotësonin kolonën. Pas këtyre veprimeve fillonte lëvizja e afrimit me shpejtësi për në vijën e hapjes për luftim. Në situatë të ndërlikuar, tanket që dlinin nga tuneli sipas radhës nuk ndalonin, por pas marrjes së pjesëtarëve të tjerë të ekuipazhit, te hyrja e tunelit vazhdonin lëvizjen drejt vijës së hapjes. Kolona plotësohej gjatë lëvizjes, duke marrë edhe masat e sigurimit gjatë afrimit.

Për mirëmbajtjen e teknikës së tankeve tregojë një përkujdesje e veçantë. Çdo të sh-tunë të javës, në bazë të një plani mujor e vjetor të mirë studiuar, i bëhej shërbimi teknikës së tankeve nga ekuipazhet e tankeve me detyra të specifikuar për çdo anëtar të ekuipazhit, nën drejtimin e komandave e shtabeve të njësisve, reparteve e nënreparteve të tankeve.

Habia e gjeneralit turk

Në vitin 1993, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë turke, Doan Gyresh bëri një vizitë në BrT të Laçit. Midis të tjerave në këtë vizitë ai shoqërohej edhe nga tekniku i brigadës së tankeve Fredi Hyra, që e njihte gjuhën turke se kishte mbaruar një kurs specializimi në Turqi. Gjenerali Gyresh u surprizua me vendosjen e tankeve në tunel në bazë toge tankesh, që siguronin daljen e shpejtë e kundërveprim të menjëhershëm, mirëmbajtjen e tyre, estetikën e ambientit brenda tuneleve, masat e sigurimit etj. Ai vendosi dorën me dorashkë të bardhë në brendësi midis rrotave mbështetëse dhe kur e hoqi prej andej, dorashka ruante atë pastërti të fillimit. Më tej, kur pa kompletin e municionit të vendosur nëpër vendet e tyre në tank pyeti teknik Fredin:

- Kështu i keni vendosur, pajisur e kompletuar me municionin luftarak të gjitha njësitë e repartet tankiste?

- Po, e njëjta rregullsi e përgjithshme kudo në tanke, përgjigjet teknik Fredi.

Ushtaraku më i lartë i ushtrisë turke i shtrëngoi dorën teknik Fredit dhe i thotë: “Ju jeni të pamposhtshëm”. Me këto përshtypje mbresëlënëse largohet gjenerali Gyresh nga BrT e Laçit për armën e tankeve në të gjithë Shqipërinë.



Luan Malaj, skënderbegasi me gjurmë të arta në publicistikë

Luan Malaj e nisi jetën e tij në qytetin e Vlorës, më 3 shtator 1951.

Në gusht 1965, filloi studimet në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej” dhe në shtator 1968 në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin Histori-Filologji, dega Gjuhë-Letërsi.

U titullua oficer, më 25 dhjetor 1972. Për më se 24 vjet, shërbeu në radhët e Ushtrisë Shqiptare, nga Porto Palermo e Himarës në Ministrinë e Mbrojtjes, si komisar kompanie, instruktor i propagandës e kulturës, redaktor i botimeve ushtarake e artistike dhe gazetar i shtypit ushtarak. Ka dalë në rezervë me gradën e nënkolonelit.

Interesi i tij për krijimtari në fushën e letërsisë nisi qysh në shkollën e mesme, ndërsa botimet e para në gjininë e poezisë e të publicistikës i përkasin viteve studentore 1968-1972. Përmbledhja e tij e vetme poetike “Nga brigjet e mia” i përket vitit 1980, por krijimtaria e tij letrare e artistike gati gjysmëshekullorë përfsihin një sasi të konsiderueshme ciklesh poetike, poemash, skicash, tregimesh, recensionesh, artikujsh kritikë e publicistikë të botuara në organet e shtypit ushtarak e atij kombëtar, si në gazetën “Luftë-tari”, “Zëri i Rinisë”, “Drita” etj., revistat “10 Korriku”, “Ushtria”, “Nëntori”, në përmbledhje me autorë të ndryshëm etj. Në tërë këtë veprimtari të gjatë letrare vëmendja e kujdesi i tij është përqendruar, jo te sasia e krijimeve apo e librave të botuar, por në radhë të parë te serioziteti i një komunikimi letrar me interes për lexuesin dhe te kujdesi për të krijuar një lloj individualiteti të tij artistik, duke i njohur plotësisht lexuesit të drejtën për ta gjykuar. Ndiheja e tij në fushën e letrave është pasuruar edhe me disa përpjekje të mira në fushën e përkthimit. Mbajnë emrin e tij, si përkthyes nga italishtja, librat “Arti i Luftës” i Sun Xu-së, “Mbi Luftën” i Klauzeviçit, “Shkretëtira e Tartarëve”, i Dino Buzatit (për revistën “Ushtria”) dhe libri me kujtime “Lufta ime më e gjatë”, i mjekut ushtarak italian, ish-togerit Franko Benanti. Gjatë periudhës së shërbimit në SHBU-së mbajnë firmën e tij si redaktor një sasi librash të botuar në poezi, prozë, publicistikë etj., nga autorë vendas dhe të huaj. Aktualisht ka në duar, të gatshëm për botim, dy libra poetikë, të cilët janë fryt i një krijimtarie poetike mbi 40-vjeçare. Prej më shumë se dy dekadash jeton familjarisht në Itali.

PËRFORCOHET PRANIA NGA DETI I ZI NË DETIN BALTIK

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg priti kryeministrin rumun Nicolae Ciucă në selinë e NATO-s, më 26 tetor 2022, për të trajtuar luftën e agresionit të Rusisë në Ukrainë dhe implikimet për sigurinë në rajonin e Detit të Zi. Z. Stoltenberg theksoi se NATO po përforcon praninë e saj nga Deti i Zi në Detin Baltik, duke përfshirë avionët luftarakë nga Kanadaja dhe mijëra trupa franceze, belge, holandeze dhe amerikane. “Thëksova se kjo dërgon një mesazh të qartë se NATO është e gatshme të mbrojë Rumaninë dhe të gjithë aleatët e tjerë”, - tha Shefi i NATO-s. Duke adresuar pretendimet e Moskës se Ukraina po përgatitet të përdorë një “bombë të pistë” radiologjike në territorin e saj, Sekretari i Përgjithshëm e përshkroi atë si “absurde”, duke shtuar se “Aleatët e hedhin poshtë këtë akuzë të rreme dhe Rusia nuk duhet të përdorë pretekste të rreme për të përshkallëzuar lufta edhe më tej”. Ai e bëri të qartë se NATO nuk do të frikësohet apo pengohet të mbështesë të drejtën e Ukrainës për vetëmbrojtje, për aq kohë sa duhet. Ai tha gjithashtu se lufta e Rusisë ndaj Ukrainës ka kthyer pjesë të Detit të Zi në një zonë lufte dhe i kërkoi Rusisë të rinovojë marrëveshjen e grurit të OKB-së të ndërmjetësuar nga Turqia, në mënyrë që ushqimi të vazhdojë të arrijë tek ata në nevojë.

Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Rumaninë për kontributet e rëndësishme që ajo jep për sigurinë tonë të përbashkët në këtë kohë të rëndësishme. Rumania investon 2% të PBB-së në mbrojtje, pret një nga grupet e reja luftarake shumëkombëshe të NATO-s, të krijuar pas pushtimit rus të Ukrainës në shkurt, si dhe një vend kyç për mbrojtjen raketore balistike të NATO-s. Takimi i ardhshëm i ministrave të Jashtëm të NATO-s do të zhvillohet në kryeqytetin rumun Bukuresht muajin e ardhshëm.

Rumania aleate shumë e vlerësuar e NATO-s

Shoqëria jonë ishte pjesë e një sistemi patriarkal, ku lidhja dhe solidariteti brenda anëtarëve të shoqërisë ishte shumë i fortë, respektimi i vlerave tradicionale dhe fetare ishin më imune ndaj dukurive negative, të cilat të çonin në ruajtjen e institucionit të shenjtë, familjes. Tashmë do të duhej llogaritur se shoqëria jonë është duke kaluar fazën më të vështirë të këtij tranzicioni, kjo bëri që shoqëria jonë për herë të parë në historinë e saj më të re të ballafaqohet me një fluks aq të madh të të huajve dhe që u përkisnin kulturave, traditave dhe civilizimeve të vendeve të ndryshme. Shqipëria u bë një vend dhe një rast i përshtatshëm për të shtrirë ndikim e tyre në shoqëri të ndryshme të panjohura për ne, me dukuri negative siç janë: narkomania, alkoolizmi, prostitucioni, bixhozi, trafikimi i krijesave njerëzore dhe krimi i organizuar, të cilat kanë qenë të panjohura për një shoqëri si ne.

Të gjitha këto zënë fill në 30 vitet e fundit, dhe për më tepër si trend i kohës fituan epitetin e një “qytetërimi” të ri dhe që karakterizon të “riun modern”.

Si erdhi tek shoqëria shqiptare ky fenomen?

Varësia nga droga ishte universale, por jo tek shoqëria shqiptare, kjo nuk zgjati shumë. Ajo filloi të kontribuojë në “zhvillimin e këtij biznesi” duke shkatërruar gradualisht edhe vetveten. Një mënyrë tjetër e vetëdijesimit mund dhe duhet bërë përmes shembujve të gjallë në të cilat janë duke kaluar shoqëritë para nesh.

Cilat janë shkaqet që shtyjnë të rinjtë të bëhen përdorues të drogës?

Nuk është e thjeshtë që të diskutohet për shkaqet që shtyjnë të rinjtë të bëhen përdorues të lëndëve narkotike. Sepse që në fillim të këtij nëntitulli duhet të përmend se njëra ndër rrethanat më favorizuese që i “ndihmon” të rinjtë është shkolla, ambient ku rinia shkollohet dhe edukohet. Kjo e fundit do të duhej të mos përmendej në këtë vend, mirëpo viteve të fundit, në vend që shkolla të ishte institucioni i vetëm ku të rinjtë të edukoheshin dhe arsimoheshin, ndodh e kundërta, e gjitha kjo është bërë një mjet dhe mënyrë më e përafërt e përhapjes së shumë dukurive negative. E themi këtë sepse jemi dëshmitarë të një realiteti të hidhur të cilin jemi duke e kaluar dhe përjetuar çdo ditë. Hapja e shumë lokaleve dhe klubeve të ndryshme pranë shkollës, ky, një rast i mirë që të rinjtë mund të argëtohen dhe pa



Mos blini vdekjen, shijoni jeten

kurrfarë presioni, qoftë prindëror apo të edukatorëve të tyre, të shfrytëzojnë të gjitha mënyrat e argëtimit që konsiderohen nga ata edhe si trendë të kohës.

Alkooli, duhani, droga, muzika dhe shumë skena tjera të paturpësisë që shfaqen në këto lokale janë edhe një mundësi e “mirë” që të rinjtë të kalojnë pushimin e gjatë në shkollë. Por edhe ata të cilët u infektuan nga kjo dukuri ishin zakonisht ata të cilët kishin problematika të ndryshme, disa

shoqërisë nga këto sëmundje. Familja do të siguronte një shoqërim të mjaftueshëm të fëmijëve, këshilla e nënës apo babait, në një familje të ngushtë apo të vetme, vështirë se do të mund të ndiqej nga një fëmijë kokëfortë, ndërsa ndikimi i kombinuar i anëtarëve të një familje të zgjeruar është i efektshëm kundër pabindshmërisë apo padëgjueshmërisë së fëmijëve. Dhe duke u rritur në një atmosferë shoqërizuese, e cila siguron kontakte të afërta me anëtarët e tjerë

të drejtë; shkolla, si vatrë e dijes ku duhet të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për mbrojtjen e rinisë nga dukuritë negative dhe e gjithë shoqëria duhet të jetë kontribuuese në luftën ndaj këtij fenomeni të rrezikshëm, vdekjeprurës të të rinjve, pasi ata janë drejtues të së nesërme.

18-vjeçarja Ana është një nga qindra përdoruesit e drogës në qytetin e Tiranës. Por një ‘Anë’ tjetër e sheh në Vlorë, Korçë, Shkodër dhe kudo nëpër Shqipëri.

Ajo me sytë gjysmë të mbyllur dhe të rrethuar me rrathë të zinj, me krahët e një zogu në rënie dhe trupin e përkulur pa mundësi fizike për t’u drejtuar si moshataret e saj në ecjet flladitëse që moshë iu dhuron, më lejoi që të kaloja me të një pjesë të ditës së saj.

“Këtu flenë shumë njerëz dhe marrin drogë.”

Ana e provoi heroinën për herë të parë para 6 vjetësh.

“Kjo është çanta tipike e një të droguari, e mbushur me sende personale për të përgatitur drogën.”

Jeta e saj përqendrohet vetëm tek një gjë: të ushqejë vesin e saj.

“Kjo është vetëm gjysmë tablete, sepse gjysmën tjetër e mora më herët. Dhe kështu përdoret heroina.”

“Heroina që shitet në këto zona është fare e lirë dhe kjo e bën atë shumë të lakmueshme për përdoruesit, sidomos për adoleshentët.”

Ana thotë se nuk i intereson se nga vjen droga që ajo përdor. Ajo thotë se heroina nuk i bën më efektin që i bënte më parë. Shqetësimi i saj është dhimbja që ajo ndjen kur trupi i kërkon heroinën.

Ajo është arrestuar tre herë dhe ka kaluar disa muaj në burg. Sapo bëhen të droguar ata fillojnë të kërkojnë drogë. Dhe kjo kthehet në një fenomen i pakëndshëm sepse këtyre të droguarve u duhet të kërkojnë vazhdimisht drogë dhe para për ta blerë atë. Pastaj fillojnë të bëjnë gjëra që nuk kishin menduar

kurër se do të bënin. Vjedhin nga prindërit e tyre, nga fqinjët ose bëhen prostituta.

Ana arrin të mbijetojë duke punuar si prostitutë në rrugë. Dhe e gjithë kjo për të blerë barin helmues.

Ana ka probleme shëndetësore, që rrjedhin nga përdorimi i drogës. Ajo është e sëmurë nga endokarditi, një infeksion i cipës së zemrës. Ajo vuan edhe nga Hepatiti C, që mund t’i dëmtojë mëlçinë. Dhëmbët po i prishen. Dhe të gjitha këto janë të zakonshme për përdoruesit e heroinës.

Ja si u përgjigj Ana kur e pyetëm nëse do ta linte ndonjëherë heroinën.

“Shpresoj të përfundoj në rehabilitim para se të vdes. Por këtë nuk e di.”

Për të droguarit ka katër mundësi: vdekja, burgu, spitali apo rehabilitimi.

“Kohët e fundit Ana u përpoq të hynte në një klinikë rehabilitimi, por nuk ia doli dot. E tradhtuan këmbët dhe sërisht u kthye në “burgun e saj”, në qoshen buzë rruge...”

Dje kalova asaj rrugice dhe pashë njerëz të grumbulluar që thërrisnin ambulancën, u afrova dhe mes tyre dallova krahun e zogut që tashmë as nuk mund të përpëlitej dhe trupi i mbledhur si një kërpudhë dalë pas shiut, nuk reagonte më.

Ana, bija e dy prindërve, që një zot e di nga cili qytet ishte, e kish humbur betejën me jetën.

Mes gishtave të zverdhur frikshëm, një gjilpërë dhe pak pluhur i bardhë.

Nuk munda të shpëtoj një jetë të re, isha mbase vonë në kohë, apo ndoshta ngulmimi ishte sipërfaqësor, ajo vajzë mund të kish qenë fëmija i kujtdo, edhe e imja pse jo?!

Detyra e gjithë shoqërisë është kujdesi i shtuar ndaj target-grupit të të rinjve, ndaj çdo fenomeni që përpiqet të prishë rrugëtimin e jetës së tyre.

Jeta do të ishte e bukur..., por vetëm nëse do t’i jepnim kuptim dhe përmbajtje të bukur, do të arrinin qëllimin e kësaj të parës.



e përdorin drogën vetëm për t’i bërë shoqëri shokut apo mikut me të cilin rri, dikush e përdor këtë për t’u larguar nga problemet, apo realiteti duke menduar se nëpërmjet kësaj rruge të mund të largojë dëshpërimin, dikush bëhet përdorues i kësaj në fillim nga kureshtja për të ndierë se çfarë shije ka, tjetri llogarit mosmarrëveshjet që ka në familje, ndonjë dashuri e pasuksesshme, suksesi i pamjaftueshëm në shkollë, dhe për t’iu shmangur kësaj dhe në kombinim të mbushjes së kësaj zbrazëtie ata bëhen të varur nga një substancë që për momentin mund t’i sjell kënaqësi, mirëpo pasojat janë shumë më të mëdha. Shtresa e cila vazhdon të jetë e prekur nga kjo dukuri janë grup moshë 16-19 vjeç dhe 20-24.

Adoleshenca, droga, familja

Familja është ajo e cila konsiderohet se do të kishte suksese në ruajtjen e

të familjes, është shumë më vështirë të vijë deri te humbja e kontrollit ndaj fëmijës, sesa në një familje bërthamë, ku në të shumtën e kohës anëtarët e saj janë të huaj dhe mysafir në shtëpi dhe në një rrethanë të tillë shumë me lehtë humb kontrollin në familje.

Biseda të shumta në lidhje me drogën dhe adoleshentët për përdorimin e tyre dhe alkoolit duhen bërë kur nuk ka gjasa të ndërpriteni, sepse është jetike për ta që kjo bisedë të jetë në parametrat më optimale të zhvillohet e plotë, e qartë, e pranueshme dhe pa zëra të ngritur.

Cili do të ishte suksesi i garantuar për të parandaluar këtë dukuri?

Shmangia, dhe mënyra e vetme për t’u larguar nga dukuritë e shëmtuara janë masat më efikase si: edukata familjare, sidomos familja e zgjeruar do të ndihmonte në ruajtjen e rinisë në rrugë

FORUMI I 7-TË EUROPIAN I MIGRACIONIT

Emigrantët e rinj dhe refugjatët duhet të kenë të njëjtën mbështetje, pavarësisht nga origjina e tyre

Shoqëria civile e organizuar europiane dhe qytetarët kanë treguar solidaritet të paprecedentë me refugjatët ukrainas, duke hapur shtëpitë e tyre, duke ndihmuar këta refugjatë të hyjnë në tregun e punës dhe duke integruar shpejt fëmijët ukrainas në shkollat europiane. BE-ja tani duhet të mësojë nga kjo histori suksesi për të ndihmuar të gjithë refugjatët dhe emigrantët, tha Forumi 2022.

I mbajtur për të shtatën herë nga Komisioni European dhe Komiteti Ekonomik dhe Social European (EESC), Forumi European i Migracionit (EMF) u fokusua në dhënien e një roli të rinjve në integrimin e emigrantëve në mënyrë që të sigurojë një rezultat të suksesshëm.

EMF, një platformë për dialogun midis shoqërisë civile, institucioneve dhe autoriteteve, hodhi në qendër të vëmendjes edukimin dhe trajnimin e të rinjve, pjesëmarrjen dhe angazhimin e refugjatëve dhe emigrantëve të rinj në shoqëri dhe jetën politike, lëvizshmërinë e të rinjve dhe sfidat dhe masat specifike që lidhen me integrimin e të rinjve, veçanërisht në sfondin e shumë refugjatëve të rinj që mbërrijnë nga Ukraina.

Presidentja e KESE-së, Christa Schweng tha: “Ne u jemi mirënjohës Shteteve Anëtare dhe organizatave të tyre të shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale për përpjekjet e jashtëzakonshme që kanë bërë për të mirëpritur dhe integruar 7.6 milionë refugjatë ukrainas, shumica prej tyre fëmijë, të rinj dhe gra”.

Megjithatë, presidenti i KESE-së paralajmëroi se ne nuk duhet të anashkalojmë emigrantët dhe refugjatët nga pjesë të tjera të botës. Ata gjithashtu meritojnë vëmendjen tonë.

Presidenti i KESE-së theksoi se



ishite e rëndësishme që të rinjtë të merrnin mbështetjen dhe udhëzimin e duhur, në drejtim të mësimi të gjuhës, arsimit dhe ndihmës sociale, që herët, në mënyrë që ata të jenë në pozitë të barabartë me homologët e tyre vendas. Kjo do t'i lejonte ata të lulëzojnë dhe të përdorin talentet e tyre, duke kontribuar gjithashtu në këtë mënyrë në shoqëri dhe në rimëkëmbjen e BE-së.

Komisionerja për Migracionin, Çështjet e Brendshme dhe Shtetësinë, Ylva Johansson, tha: “Ne donim të inkurajonim solidaritetin e treguar nga qytetarët europianë ndaj refugjatëve ukrainas dhe të vazhdonim këtë moment. Të gjithë kemi punuar së bashku me një qëllim të vetëm. Së bashku i përballuam të gjitha sfidat”.

Falë përpjekjeve të organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale dhe kombëtare në terren, miliona refugjatë ukrainas gjetën shpejt shtëpi në

komunitetin lokal. Rreth 670 000 fëmijë nga Ukraina po shkojnë tani në shkollë në BE dhe mësuesit ukrainas mund të japin mësim në shkollat europiane falë njohjes së shpejtë të aftësive dhe kualifikimeve të tyre. Të paktën 400 000 ukrainas kanë gjetur punë deri më tani.

Përveç ndihmës me financim dhe koordinim, Komisioni ka nisur disa iniciativa për të ndihmuar më tej refugjatët të integrohen, të tilla si “Iniciativa e Shtëpive të Sigurta” dhe “Piloti i Talenteve”, i cili synon të përputhë aftësitë e punëkërkuarve me vendet e lira të punës. Si plani i veprimit për integrimin dhe përfshirjen, ashtu edhe paketa e aftësive dhe talenteve të migracionit legal synojnë të përmirësojnë integrimin.

“Në tetë muajt e fundit, ne kemi bërë histori së bashku. Ne duhet të mësojmë nga kjo përvojë për të ndihmuar të gjithë refugjatët dhe emigrantët. Ne

duhet të mësojmë se si mund të ndërtojmë sisteme edhe më të mira në të ardhmen dhe si mund të përdorim atë që po bëjmë tani për të na frymëzuar që të jemi më të përgatitur për krizat e ardhshme të migracionit dhe për integrim. Ne duhet të ndërtojmë një Europë ku të gjithë mund të ndihen si në shtëpinë e tyre”, - tha Komisionerja.

Zonja Johansson theksoi se e drejta për këtë nivel mbrojtjeje për refugjatët ukrainas u mundësua nga Direktiva e Mbrojtjes së Përkohshme, e aktivizuar për herë të parë në 20 vitet që ekziston. Direktiva garanton të njëjtin standard mbrojtjeje për refugjatët në të gjitha shtetet anëtare, gjë që nuk do të ishte ndryshe. Megjithatë, kjo direktivë ka një datë skadence dhe nuk mund të zgjatet pafundësisht.

Duke zgjatur dy ditë (20 dhe 21 tetor), EMF u dha fjalën më shumë se 120 organizatave të shoqërisë civile nga i gjithë Bashkimi European, si dhe përfaqësuesve nga autoritetet lokale dhe rajonale, shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së. EMF tregoi se si shoqëria civile po ndihmon refugjatët e rinj dhe njerëzit me prejardhje emigrante, duke përfshirë ata nga Siria, Afganistani dhe Republika Demokratike e Kongos, përmes një sërë aktiviteteve si mentorimi dhe sporti. EMF mirëpriti gjithashtu liderë të rinj të jashtëzakonshëm nga e gjithë bota, si Filipinet dhe Ballkani Perëndimor, të cilët i kujtuan audiencës rëndësinë e dhënies së zërit të të rinjve. Tema dhe programi për ngjarjen u mbështet në kontributin e organizatave të shoqërisë civile të dhëna gjatë konsultimeve në pranverën e vitit 2022.

EMF organizoi një numër panelesh

dhe seminaresh interaktive, të tilla si mbi emigrantët e rinj si aktorë të përfshirjes së të rinjve dhe mbi pjesëmarrjen e të rinjve, aksesin në arsim dhe lëvizshmërinë e të rinjve. Në agjendë ishin edhe qëndrimet e publikut ndaj emigrantëve. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e nisjes së fushatave të bazuara në shpresë, të cilat mbështeten në fakte dhe shifra si dhe në lidhje emocionale për të bashkuar njerëzit. Kjo mund të jetë e dobishme për të ndihmuar në ndryshimin e mentalitetit dhe ndryshimin e narrativës, të cilat shpesh bazohen në frikë dhe negativitet.

KESE ka qenë aktive në përfaqësimin e organizatave rinore si dhe në asistimin e refugjatëve ukrainas. Nëpërmjet organizatave të tyre, anëtarët e KESE-së kanë ndihmuar në mënyrë aktive refugjatët ukrainas në terren. EESC pret një qendër ukrainase të shoqërisë civile, ku rreth 30 përfaqësues të shoqërisë civile mund të vazhdojnë punën e tyre. Nëpërmjet Platformës së Shoqërisë Civile BE-Ukrainë, anëtarët e KESE janë në kontakt të rregullt me homologët e tyre ukrainas.

Në të njëjtën kohë, KESE ka bërë të pamundurën për të siguruar që veprimet dhe iniciativat që po zhvillohen për të ndihmuar njerëzit që ikin nga Ukraina, veçanërisht aktivizimi i Direktivës së Mbrojtjes së Përkohshme, të bëhen standardi për veprimin e BE-së në raste të ngjashme në të ardhmen.

Nëpërmjet opinionëve dhe dëgjimeve të saj, KESE ka kërkuar gjithashtu lëvizje për të forcuar pjesëmarrjen e të rinjve në tregun e punës dhe për të forcuar aftësitë dhe talentet e të gjithë të rinjve, përfshirë emigrantët.

Shpyllëzimi, shkaqet dhe si po e trajton BE-ja

Shkalla e humbjes së pyjeve në mbarë botën është alarmante. Rreth 420 milionë hektarë pyje u humbën për shkak të shpyllëzimit midis viteve 1990 dhe 2020, sipas Organizatës së OKB-së për Ushqimin dhe Bujqësinë, një zonë sa madhësia e BE-së. Shpyllëzimi është shkatërrimi i pyjeve në mënyrë që toka të përdoret për përdorime të tjera, ndërsa degradimi i pyjeve është një proces më gradual që lidhet me humbjen e kapacitetit të pyjeve për të prodhuar përfitime thelbësore, si druri apo biodiversiteti.

Këto procese zhvillohen kryesisht në tre pellgjet kryesore pyjore të Amazonës (Amerika e Jugut), Kongo (Afrika Qendrore) dhe Azia Juglindore. Procesi i kundërt po ndodh në BE, ku pyjet u rritën me 10% midis 1990 dhe 2020. Megjithatë, humbja e pyjeve është një problem global që BE-ja dëshiron të trajtojë për të luftuar dëmtimin mjedisor dhe ndryshimet klimatike.

Cilat janë shkaqet e shpyllëzimit dhe degradimit të pyjeve?

Shpyllëzimi dhe degradimi i pyjeve janë kryesisht për shkak të aktiviteteve njerëzore si:

Bujqësia industriale

Bujqësia është shtytësi kryesor i shpyllëzimit në të gjitha rajonet, përveç Europës.

Shndërrimi i pyjeve në tokë bujqësore është nxitësi kryesor i humbjes



Në disa vende, pyjet tropikale shkatërrohen për t'i lënë vend vajit të palmës

së pyjeve. Sipas Organizatës së OKB-së për Ushqimin dhe Bujqësinë, ajo shkakton të paktën 50% të shpyllëzimit global, kryesisht për prodhimin e vajit të palmës dhe sojës.

Kullotja e bagëtive është përgjegjëse për pothuajse 40% të shpyllëzimit global.

Në Europë, shndërrimi në tokë bujqësore përfaqëson rreth 15% të shpyllëzimit dhe 20% është për shkak të kullotjes së bagëtive.

Urbanizimi

Zhvillimi urban dhe i infrastruk-

turës, duke përfshirë ndërtimin dhe zgjerimin e rrugëve, përfaqësojnë shkakun e tretë më të madh të shpyllëzimit global, duke zënë pak më shumë se 6% të totalit. Në Europë është shkak kryesor i shpyllëzimit.

Mbi-shfrytëzimi i burimeve drusore

Aktivitetet të tjera dëmtuese që lidhen me aktivitetet njerëzore përfshijnë mbi-shfrytëzimin e drurit, duke përfshirë karburantin dhe prerjet ilegale ose të paqëndrueshme.

Ndryshimi i klimës

Ndryshimet klimatike janë njëko-

hësisht shkak dhe pasojë e shpyllëzimit dhe degradimit të pyjeve. Ngjarjet ekstreme që shkaktohen nga zjarret, thatësitat dhe përmbytjet, prekin pyjet. Nga ana tjetër, humbja e pyjeve është e dëmshme për klimën, pasi pyjet luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e ajrit të pastër, rregullimin e ciklit të ujit, kapjen e CO2, parandalimin e humbjes së biodiversitetit dhe erozionit të tokës.

Konsumi nga BE i mallrave të prodhuara në tokat e shpyllëzuara

Pjesa më e madhe e pyjeve tropikale të konvertuara në përdorim bujqësor shkon për të prodhuar mallra të tregtuara globalisht. Konsumi i BE-së përbën rreth 10% të shpyllëzimit global, kryesisht vaj palme dhe soje, të cilat përbëjnë më shumë se dy të tretat.

Sipas vlerësimit të ndikimit të Komisionit European, këto janë produktet kryesore të importuara nga BE nga tokat e shpyllëzuara:

vaj palme	34%
Soja	32.8%
Dru	8.6%
kakao	7.5%
Kafe	7%
gomë	3.4%
misër	1.6%

Drejt një rregulloreje të BE-së për produktet pa shpyllëzim

Shpyllëzimi dhe degradimi i pyjeve kanë një ndikim në objektivat mjedisore të BE-së si lufta kundër ndryshimeve klimatike dhe humbjes së biodiversitetit, por edhe në të drejtat e njeriut, paqen dhe sigurinë.

Kjo është arsyeja pse BE-ja përpiqet të luftojë humbjen globale të pyjeve. Në shtator 2022, Parlamenti miratoi qëndrimin e tij mbi rregulloren e Komisionit European për produktet pa shpyllëzim, i cili do t'i detyrojë kompanitë të verifikojnë që produktet e shitura në BE nuk janë prodhuar në tokë të shpyllëzuar ose të degraduar.

Parlamenti dëshiron të shtojë më shumë produkte në listë dhe të sigurojë që të drejtat e njeriut dhe të drejtat e popujve indigjenë të respektohen.

Në korrik 2021, Komisioni prezantoi Strategjinë e Re të BE-së për Pylltarinë 2030, e cila synon të rrisë sasinë dhe cilësinë e pyjeve të BE-së dhe të promovojë rolin e tyre si thithës të karbonit.

10 NGA ARMËT E FORCAVE SPECIALE AMERIKANE

FN SCAR

Pushka sulmuese luftarake e Forcave të Operacioneve Speciale (SCAR) është një pushkë modulare e bërë nga FN Herstal (FNH) për Komandën e Operacioneve Speciale të Shteteve të Bashkuara (SOCOM), për të përmbushur kërkesat e konkursit SCAR. Kjo familje pushkësh përbëhet nga dy lloje kryesore. SCAR-L, për "dritë", është i vendosur në fishekun 5.56×45 mm të NATO-s dhe SCAR-H, për "të rëndë", për qitje e NATO-n 7.62×51 mm. Të dyja janë të disponueshme në variantet e betejës në distanca të afërta apo të largëta.



HK MP5

Heckler & Koch MP5 (nga gjermanishtja: Maschinepistole 5, "pistoletë automatik modeli 5") është një automatik 9 mm i dizajnit gjerman, e zhvilluar në vitet 1960 nga një ekip inxhinierësh nga prodhuesi gjerman i armëve të vogla "Heckler & Koch GmbH" (H&K) e "Oberndorf am Neckar". Ka mbi 100 variante të MP5, duke përfshirë një version gjysmë automatik.



KARABINA M4

Karabina M4 është një familje armësh zjarri që rrjedh nga versionet e mëparshme të karabinës të pushkës M16, e cila nga ana e saj rrjedh nga pushka origjinale AR-15 që Eugene Stoner dhe "ArmaLite" projekttoi dhe prodhoi. M4 është një variant më i shkurtër dhe më i lehtë i pushkës sulmuese M16A2. Është një armë zjarri selektive e përdorur me gaz, e ushqyer me karikatorë, me përdorim nga shpatulla, me një stacion teleskopik dhe tytë 14,5 inç (370 mm) për të lehtësuar luftimin nga afër. Ashtu si pjesa tjetër e familjes M16, ai gjuan kalibrin 223, ose 5.56 mm të NATO-s.



HK MK23 SOCOM 45

Heckler & Koch MK 23, Mk 23 Mod 0, Mark 23, ose MARK 23, është një sistem armësh i përbërë nga një pistoletë gjysmë automatike e shkallës së ndeshjes, një modul synimi lazer (LAM) dhe shtypës. Ai u miratua nga Komanda e Operacioneve Speciale të Shteteve të Bashkuara (US-SOCOM) për njësitë e operacioneve speciale në vitet 1990 si një pistoletë sulmuese. Prodhimi filloi në 1991, dhe ishte baza për HK USP, e cila filloi prodhimin në 1993.



HK MP7

MP7 është një armë gjermane e mbrojtjes personale (PDW) e prodhuar nga "Heckler & Koch" (H&K) dhe e vendosur për fishekun HK 4.6×30 mm. Ajo u projektua me fishekun e ri për të përmbushur kërkesat e NATO-s të botuara në 1989, pasi këto kërkesa kërkonin një armë zjarri të klasës së mbrojtjes personale (PDW), me një aftësi më të madhe për të mposhtur armaturën e trupit sesa armët aktuale të kufizuara në fishekë konvencionalë pistolette. MP7 hyri në prodhim në vitin 2001. Ai është një rival i drejtpërdrejtë i FN P90, i zhvilluar gjithashtu në përgjigje të kërkesës së NATO-s. Arma është rishikuar që nga prezantimi i saj dhe versioni aktual i prodhimit është MP7A1.



HK P11

Meqenëse fishekët në formë të zakonshme janë të pasaktë dhe kanë një distancë shumë të shkurtër kur përdoren nën ujë, kjo pistoletë lëshon shigjeta çeliku rreth 10 centimetra (3,9 in) të gjata. Ajo ka pesë tyta, secila prej të cilave është e mbushur me një fishek, duke i dhënë armës një pamje si kuti piper, dhe ajo ndizet në mënyrë elektrike nga një paketë baterie në dorezën e pistoletës. Pas shkrpjes së pesë fishekëve, njësia e tytës duhet t'i dërgohet prodhuesit të saj për rimbushje. Ai është shumë i ngjashëm me paraardhësin e tij, Mk 1 (armë brojtëse për nën ujë). Në të kaluarën, "Heckler & Koch" ka mohuar njohurinë për ekzistencën e saj.



REMINGTON MODELI 870 SHOTGUN

Remington Modeli 870 është një armë gjahu me pompë e prodhuar në SHBA, e prodhuar nga "Remington Arms Company", LLC. Përdoret gjerësisht nga publiku për



qitje sportive, gjueti dhe vetëmbrojtje. Përdoret gjithashtu zakonisht nga organizatat e zbatimit të ligjit dhe ushtria në mbarë botën.

PUSHKE SULMUESE AK-47

AK 47 është një pushkë sulmi 7.62×39 mm me zjarr selektiv, me gaz, e zhvilluar për herë të parë në Bashkimin Sovjetik nga Mikhail Kalashnikov. Komanda e Operacioneve Speciale të SHBA-së ka AK 47 në inventar për një sërë misionesh. Është një nga armët më të besueshme të bëra ndonjëherë dhe bën një zgjedhje të shkëlqyer kur duhet të notosh një armë mbi plazh. Edhe pas gjashtë dekadash, modeli dhe variantet e tij mbeten pushkët më të njohura dhe më të përdorura në botë për shkak të besueshmërisë së tyre të konsiderueshme edhe në kushte të vështira, kostove të ulëta të prodhimit në krahasim me armët bashkëkohore perëndimore, disponueshmërisë në pothuajse çdo rajon gjeografik dhe lehtësisë së përdorimit.



PUSHKA ANTIMATERIALE BARRETT M82

M82 është një pushkë kundër-materiale gjysmë-automatike e operuar me zmbropsje e zhvilluar nga kompania amerikane "Barrett Firearms Manufacturing". Një SASR e rëndë (Pushkë me shtrirje speciale), përdoret nga shumë njësi dhe ushtri në mbarë botën. Quhet gjithashtu "Light Fifty" për dhomëzën e saj 0,50 BMG (12,7×99 mm NATO). Arma gjendet në dy variante, M82A1 origjinale (dhe A3) dhe "bullpup" M82A2. M82A2 nuk prodhohet më, megjithëse XM500 mund të shihet si pasardhësi i tij.



M249 MITRALOZ I LEHTE

Mitralozi i lehtë M249 (LMG), i emërtuar më parë Arma Automatike e Skuadrës M249 (SAW) dhe e shkruar zyrtarisht si Mitralozi i lehtë, 5.56 mm, M249, është përshtatja amerikane e belg FN Minimi, një mitraloz i lehtë i prodhuar nga Kompania belge FN Herstal (FN). M249 është prodhuar në Shtetet e Bashkuara nga filiali lokal FN Manufacturing LLC në Karolinën e Jugut dhe përdoret gjerësisht në Forcat e Armatosura të SHBA. Arma u prezantua në vitin 1984 pasi u vlerësua si më efektive nga një numër armësh kandidate për të trajtuar mungesën e fuqisë automatike të zjarrit në njësitë e vogla. M249 u siguron skuadrave të këmbësorisë vëllimin e madh të zjarrit të një mitralozi të kombinuar me saktësinë dhe transportueshmërinë që i afrohet asaj të një pushke.



NGA KOLANA "SKËNDERBEGASIT NDËR VITE"

Skënderbegasi Hajro Leskaj, ushtarak, sportist dhe gjyqtar i FIFA-s. Një nga skënderbegasit që ka bërë emër në sportin shqiptar është dhe Hajro Leskaj. Hajro ka bërë emër si atlet, në basketboll, atletikë, gjimnastikë dhe futboll, duke u bërë dhe pjesëtar i ekipit të të rriturve të "Partizanit" në futboll. Njëkohësisht, Hajro Leskaj është i njohur dhe si gjyqtar futboll, duke qenë dhe gjyqtar i FIFA-s, e duke gjykuar shumë aktivitete ndërkombëtare në Shqipëri dhe jashtë saj.

Hajro Leskaj lindi në Bolenë të Vlorës, më 18 janar 1947. Shkollën 7-vjeçare e kreu në Tiranë, mandej ndoqi shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej" në vitet 1962-1966, duke qenë ndër sportistët e talentuar në shumë disiplina, e duke tërhequr dhe vëmendjen e trajnerëve të ekipeve të ndryshme. Leskaj, në vitin 1969 përfundoi Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe u titullua oficer aktiv në specialitetin kundërrajor. Në vitin 1974 u diplomua në IKF "Vojo Kushi" në Tiranë. Fillimisht punoi pedagog i edukimit fizik në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, deri në vitin 1977. Për disa vjet ka qenë mësues i edukimit fizik në shkollat e rrethit të Tiranës. Në vitet 1993-1998 ishte instruktor i edukimit fizik në Drejtorinë Arsimore të Qytetit të Tiranës, ndërsa nga viti 1999 e në vazhdim, emërohet në Drejtorinë Arsimore të Rrethit të Tiranës. Karrierën e sportistit e filloi si akrobat në Pallatin e Pionierëve në Tiranë. Në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej" u mor me basketboll, gjimnastikë, atletikë e futboll me ekipet e të rinjve të "Partizanit". Në vitet 1965-1976 ishte futbollist i ekipit të të rriturve të "Partizanit". Në vitet 1978-1996, gjyqtar futboll dhe mori titullin "Gjyqtar futboll". Në vitin 1992 mori titullin "Gjyqtar i FIFA-s". Aktualisht është në pension.

Skënderbegasi Hajro Leskaj, ushtarak, sportist dhe gjyqtar i FIFA-s



Bashkim Likaj, mundës, trajner e gjyqtar ndërkombëtar

Skënderbegasi Bashkim Lika është një nga ikonat e mundjes shqiptare, me emër dhe në aktivitet ndërkombëtare, ku ai ka marrë pjesë para vitit 1990. Ndërkohë, një aktivitet të suksesshëm ai ka dhe si trajner mundje për ekipin e "Partizani" ku ka fituar shumë trofe.

Bashkim Lika lindi në Tiranë më 29 janar 1949. Pasi mbaroi shkollën 7-vjeçare në kryeqytet, ndoqi shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej" (1963-1967), Institutin e Fizkulturës "Vojo Kushi" (1968-1971) dhe Shkollën e Lartë të Partisë "Vladimir Iliç Lenin" (1976-1978). Fillimisht u mor me edukimin fizik në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve (1971-1974), mandej ishte trajner profesionist i mundjes në Klubit Sportiv "Partizani". Në vitet 1987-1992 ishte pedagog dhe drejtues i Katedrës së Përgatitjes Fizike në Akademinë Ushtarake "Skënderbej", ndërsa pas vitit 1997 specialist



i edukimit fizik në Ministrinë e Mbrojtjes. Në vitet 1968-1969 ka qenë kampion mundjeje për të rinj, në vitet 1970-1971-1972 kampion kombëtar për të rritur. Si trajner i ekipit "Partizani" të mundjes, ka koleksionuar 10 tituj kampion kombëtar, 10 kupa republike, 2 kupa të spartakiadës kombëtare. Ka bërë disa takime miqësore ndërkombëtare, ku ka fituar dy herë me nënkampionët e Europës dhe dy herë me mundës të kalibrit botëror. Ka qenë 10 vjet trajner i ekipit kombëtar të mundjes, duke zënë vendet e 11-14 në Europë, president i Federatës Shqiptare të Mundjes në vitet 1990-1992 dhe Gjyqtar i Kategorisë Ndërkombëtare. Mban Urdhrin "Naim Frashëri" të Klasit I dhe "Ylli i Kuq" të Klasit II. Është kryetar i Komitetit Drejtues të Sporteve në Ushtri.

Kujtim Boriçi
Maksim Fejzullahu

Korça, djepi i atdhetarizmit, feston 78 vite pavarësi

Brigada IX Sulmuese u formua në katundin Lozhan të Gorës, qarku i Korçës, më 16 tetor 1944. Shtabi i brigadës ishte i përbërë nga Irakli Bozo, komandant; Mihallaq Ziçishti, komisar; Petro Papi, zëvendës komisar; Meleq Babani, përgjegjës rinie dhe Vangel Marko, intendent.

Kjo brigadë u krijua me qëllimin e shtimit të veprimeve ushtarake në zonën e Korçës. Detyra ishte të eliminonte autokolonat armike që lëviznin në aksin Janinë-Korçë-Manastir-Follorinë, Korçë-Pogradec-Tiranë, por detyra më e rëndësishme ishte çlirimi i qyteteve të Korçës, Ersekës dhe Bilishtit.

Me marrjen e këtyre qyteteve, armikut i priteshin rrugët e komunikacionit dhe paralizoheshin tërheqja e ushtrisë gjermane nga Greqia për në Jugosllavi nëpërmjet territori shqiptar.

Urdhri për krijimin e brigadës u dha nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në përbërje të tij u caktuan batalione me përvojë në luftë kundër pushtuesve. Inaugurimi i brigadës u bë para efektivit të saj, ku u rreshtuan të gjithë batalionet e saj. Brigada kishte një armatim që e dispononte e gjithë ushtria shqiptare në atë moment, ajo kishte armë të dhuruara nga populli, por edhe nga ndihmat aleate të hedhura me parashutë, si armë automatike, por që nuk plotësonin të gjithë numrin e pjesëtarëve të brigadës. Brigada ishte e pajisur me shërbim shëndetësor. Pranë shtabit të brigadës qëndronte një mjek dhe 2-3 infermiere vullnetare.

Pas ngritjes së Shtabit Operativ për çlirimin e Korçës, Brigada IX, që përbënte dhe një nga forcat kryesore pjesëmarrëse në operacion, kishte në përbërje të saj 1 580 partizanë. E gjithë forca partizane në zonën e Korçës arrinte në 3 000 veta, po të shtohen këtu edhe partizanët e Brigadës II me 1 150, dhe brigada e XX me 430. Këtu mund të shtojmë edhe forcat guerile që vepronin brenda në qytete, si në Korçë dhe Bilisht, të cilat arrinin në rreth 1 000 vetë.

Forcat armike që kontrollonin zonën e Korçës ishin më të pakta në numër, por të pajisura dhe mbështetura në tanke dhe artileri. Këto forca armike kishin nën kontroll vetëm rrugët kryesore dhe duhej të siguronin tërheqjen e forcave gjermane nga Greqia në Jugosllavi, e cila përbëhej nga Korparmata e 21.



Autori i fotove të rralla, ditën e çlirimit të Korçës, më 24 tetor 1944, është Jonuz Baliko Latollari (1887-1970) nga Panarit-Grabockë Korçë, pjesëmarrës në të dy Luftërat Botërore.

Në bazë të urdhrave të Shtabit të Operacionit, batalionet e brigadës morën të gjithë detyra të ndryshme në zona të ndryshme, në bashkëpunim me batalionet e brigadave ndihmëse. Batalioni I u caktua të asgjësonte garnizonin e Kolonjës dhe Leskovikut. Batalioni i II duhej të kontrollonte disa prej katundeve që kishin pranë rrugën automobilistike Qafë e Qarrit - Korçë. Batalioni III duhet të sulmonte garnizonin e Bilishtit dhe të kontrollonte kufirin në zonën e Kapshticës. Batalioni IV në bashkëpunim me batalionin I të brigadës së II duhej të sulmonte garnizonin e qytetit të Korçës dhe çlirimin përfundimtar të qytetit. Disa prej tyre edhe u diktuan në momentin kur dhe do të zinin pozicionet e luftimit, ata u goditën nga zjarri i artilerisë armike. Katër batalionet e brigadës u vendosën sipas urdhrit në pozicionet e caktuara. Të parët që u ndeshën me forcat armike ishin partizanët e batalionit I, të cilët mundën të futeshin thellë në linjat armike.

Nga Janina po tërhiqej një auto-

kolonë e madhe me gjermanë, të cilët rrugës do të mbledhnin edhe disa nga garnizonet që kishin në Leskovik, Korçë dhe Bilisht. Kjo autokolonë u sulmua nga batalioni I i Brigadës IX në bashkëpunim me batalionin II të Brigadës II. Lufta ishte e ashpër, me sulme e kundërsulme, por falë errësirës, autokolona arriti të dalë nga rrethimi dhe të largohet në drejtim të Korçës. Ky largim i gjermanëve lejoi që forcat partizane të futen në qytetet e Leskovikut dhe Ersekës.

Në mesin e tetorit forcat partizane kishin nën kontroll të gjithë krahinën e Kolonjës, në dorë të tyre kishin rënë shumë materiale ushtarake të lëna nga armiku në ikje e sipër.

Të katër batalionet raportonin suksese në zonat ku ishin caktuar. Ato filluan sulmin kundër forcave gjermane që gjendeshin të pozicionuara jashtë Korçës, duke pasur sukses dhe duke shkaktuar panik midis armikut. Kjo bëri që ato të tërhiqeshin në mënyrë të çrregullt drejt Korçës. Batalioni i katërt tentoi me sukses edhe bllokimin e rrugës Korçë-Pogradec, kjo i detyroi

forcat naziste të mos kishin asnjë komunikim me forcat jashtë, duke shuar edhe shpresën për ndonjë ndihmë të mundshme. Ky ishte një sukses në fushën e betejës për dy brigadat që organizuan sulmin. Suksesi ishte edhe për komandën e brigadës, e cila kishte vetëm pak kohë që ishte krijuar.

Në bashkëpunim me Brigadën II, Brigada IX iu afrua lagjeve të jashtme të Korçës. Menjëherë mbi qytet filluan sulme të organizuara me qëllim shqetësimin e armikut. Duke e zgjatur vijën e luftës, partizanët po ngushtonin rrethimin e armikut. Të gjendur në dëshpërim gjermanët tentonin të tërhiqeshin prapa, andej nga kishin ardhur, nga kufiri grek. Forcat zbuluese partizane mundën të lokalizojnë saktësisht vendosjen e armikut dhe mënyrën se si mbroheshin. E gjithë kjo u arrit në bashkëpunim me forcat guerile që ndodheshin në qytet. U dha urdhër që rrethimi të ngushtohet edhe më shumë, forcat partizane intensifikuan sulmet, ato arritën deri në pazarin e qytetit, duke u ndeshur dhe trup me trup me gjermanët.

Kjo i detyroi gjermanët që ta përqendronin çarjen e rrethimit në një pikë, verilindjen. U përdorën të gjitha armët e mundshme, që nga artileria dhe autobлиндat. Ata filluan të hidhnin në erë shumë pika strategjike të qytetit, por sidomos depon e municioneve, shpërthimi i së cilës shkaktoi një gjendje alarmi. Gjermanët kishin lënë vetëm një shteg për t'u tërhequr, shteg, i cili u bllokua menjëherë nga forcat partizane. Vetëm një pjesë e tyre mundi të shpëtojë dhe të largohet nga qyteti. Pjesa tjetër u vra ose u kap rob nga partizanët. Ky ishte edhe sulmi i fundit i partizanëve, të cilët mundën ta çlironin përfundimisht qytetin e Korçës. Mbetej të bëhej edhe çminimi i zonave të pashpërthyer, operacion që u krye në bashkëpunim me njësitet guerile të qytetit. I gjithë qëllimi i gjermanëve ishte të hidhej në erë qyteti i Korçës, që forcat naziste të kishin mundësi të largoheshin të pa shqetësuar.



PAS NGRITJES SË SHTABIT OPERATIV PËR ÇLIRIMIN E KORÇËS, BRIGADA IX, QË PËRBËNTE DHE NJË NGA FORCAT KRYESORE PJESË-MARRËSE NË OPERACION, KISHTE NË PËRBËRJE TË SAJ 1 580 PARTIZANË.

Menjëherë forcat partizane dhe më saktësisht batalioni I i brigadës IX dhe ai I i brigadës II, u vunë në ndjekje të forcave armike. Forcat partizane iu drejtuan qytetit të Bilishtit, i cili mbahej akoma nga forca naziste. Qyteti u rrethua, por partizanët u gjendën përballë një sulmi të artilerisë armike. Pas shumë përpjekjesh partizanët i detyruan gjermanët të tërhiqeshin nga pozicionet e zjarrit dhe të strukeshin në kazermat e qytetit. I gjithë sulmi vazhdoi tërë natën e 25 tetorit duke i bërë gjermanët të tërhiqeshin drejt kufirit grek.

Edhe pse dolën nga kufiri shqiptar gjermanët u ndoqën dhe u sulmuan duke u shpartalluar përfundimisht. Partizanët e Brigadës IX u futën dhe ndihmuan popullin grek nga forcat gjermane, në katundet e Drenovës. Operacionet për çlirimin e Korçës u kryen në një kohë të shpejtë. Kjo ishte rezultat i bashkëveprimit me batalionet e tjera të Brigadës II. Populli i Korçës iu rezervoi një pritje të madhe partizanëve kur këta u futën në qytet, për nder të tyre u organizuan koncerte e festime. Populli i Korçës doli i gjithi nëpër rrugë dhe festoi me partizanët çlirimin e qytetit. Kori i qytetit, për nder të kësaj ngjarjeje këndoi këngë patriotike, sidomos një këngë e cila ishte përgatitur posaçërisht për këtë ditë.

Por shfaqje të tilla gëzimi kishte edhe në qytetet e tjera si Bilisht dhe në gjithë qarkun e Korçës, të cilat zgjatën tërë natën deri në mëngjes.

Menjëherë pas çlirimit të qarkut të Korçës, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, dy nga batalionet e brigadës IX u vendosën në mbrojtje të qytetit të Korçës dhe dy të tjerë në mbrojtje të qytetit të Bilishtit. Detyrë ishte edhe mbrojtja e kufirit me Greqinë, e cila po mbante një qëndrim agresiv ndaj popullit shqiptar sidomos çamëve. Pas qetësimit të gjendjes forcat e Brigadës IX, që tashmë kishin hyrë në përbërje të Divizionit IV, morën urdhër të largohen nga qarku i Korçës dhe të vendosen në Shqipërinë e Mesme në rajonin Krujë-Ishëm-Kavajë.



NJOFTIM!

Qendra e Personel - Rekrutimit ka filluar regjistrimin e kandidatëve për **ushtarë/detarë aktiv** dhe kërkon të rekrutojë, për periudhën **09.01.2023 - 17.03.2023**, gjithsej **389** kandidatë.

Afati për dorëzimin e **dokumentacionit** është deri më 15 dhjetor 2022.

Jam krenar që jam pjesë e Forcave të Armatosura!

